

Fusha nr.5 Klima dhe kultura në shkollë

<i>Treguesi i cilësisë</i>	<i>Temat</i>
5.1 Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	• Prestigji / imazhi i shkollës • Kodi i sjelljes • Atmosfera e shkollës • Sjellja dhe disiplina në shkollë • Participimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve
5.2 Promovimi i arritjeve	• Promovimi i arritjeve personale të nxënësve • Promovimi i arritjeve në emër të shkollës
5.3 Barazia dhe drejtësia	• Njohja e të drejtave të fëmijëve • Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve • Pranimi dhe promovimi i multikulturalizmit
5.4 Marrëdhënie partnere me prindërit, me bashkësinë lokale dhe me komunitetin afarist	• Bashkëpunimi i shkollës me prindërit • Bashkëpunimi me bashkësinë lokale • Bashkëpunimi me komunitetin afarist dhe sektorin joqeveritar

5.1 Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë

<i>Burimi i të dhënave</i>	<i>Niveli i evaluimit: Shumë mirë</i>
• Kodi i sjelljes • Anketat dhe intervistat gojore me mësime dhënësit, prindërit dhe nxënësit • Evidenca pedagogjike për masat e shqiptuara pedagogjike • Statuti i shkollës • Rregulli shtëpiak i shkollës • Lëvdatat, çmimet, mirënjohjet etj.	- Prestigji/imazhi i shkollës Procesi edukativ-arsimor në shkollën tonë zhvillohet në dy objekte shkollore, në atë qendrore në Svillarë të Poshtme dhe në shkollën periferike në Svillarë të Eperme. Shkolla jonë njihet sipas cilësisë së lartë të punës dhe sipas arritjeve të nxënësve në lëmi të ndryshme si dhe sipas realizimit të vizionit dhe misionit të shkollës. Shkolla kujdeset për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve edhe atë duke bërë kontrollimin dhe vaksinimin e tyre për çdo vit. Këtë më së miri e shohim në evidencën e kartoneve mjekësore si dhe në ditarët e klasave në rubrikën shëndeti i nxënësve. Në shkollën tonë organizojmë edhe prezente nga mjekët që çdo 6 muaj vijnë dhe kontrollojnë nxënësit tanë, kushtuar sëmundjeve ngjitëse si dhe mbrojtja e nxënësve nga duhani dhe alkoholi. Sa i përket sigurimit të nxënësve, shkolla jonë ka zgjedhur kompaninë adekuate për sigurim. - Kodi i sjelljes Shkolla jonë posedon kod të sjelljes me anë të së cilit janë përcaktuar parimet dhe dispozitat e sjelljes së të gjitha strukturave në shkollë. Gjatë miratimit të këtij kodi kanë marrë pjesë përfaqësues të të gjitha strukturave (Kudri udhëheqës, shërbimi profesional, personeli teknik, nxënësit dhe prindërit).

-Atmosfera në shkollë

Gjatë vitit shkollor 2022/23 dhe 2023/24 marrëdhëniet midis nxënësve dhe kuadrit arsimor bazohen në respektimin reciprok mes tyre. Gjithashtu vlen të theksojmë se në shkollën tonë kemi nxënës vetëm të etnitetit shqiptar. Lirisht mund të themi se marrëdhëniet ndërmjet nxënësve janë në nivel sepse mbizotëron toleranca, respekti dhe bashkëpunimi në mes tyre. Karakteristike është se në shkollën tonë nuk ka dallime të nxënësve në bazë të aftësive psiko-fizike si dhe gjinore.

- Disiplina

Në shkollën tone disiplina është në nivel këtë vit sepse ka atmosferë pune gjatë mësimit dhe aktiviteteve jashtëmësimore. Ka bashkëpunim mes kuadrit arsimor dhe nxënësve. Shkolla e respekton rregulloren e masave pedagogjike dhe lirisht mund të themi se nuk kemi të propozuar asnjë masë pedagogjike nga ana e kujdestarëve të klasave sa i përket masave më të rënda.

- Participimi i nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve

Shkolla ka bashkësi të nxënësve të zgjedhur nga ana e klasave. Kjo bashkësi është zgjedhur në mënyrë demokratike. Ata janë të informuar me kohë për çdo problem dhe marrin pjesë direkte në zgjidhjen e tyre.

5.2 Promovimi i arritjeve

<i>Burimi i të dhënave</i>	<i>Niveli i evaluimit: Shumë mirë</i>
• Raportet dhe analizat statistikore • Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik • Evidencë e nxënësve që janë shpëngulur dhe atyre që kanë ardhur • Biseda me shërbimin profesional • Biseda me mësimdhënësit	- Promovimi i arritjeve personale të nxënësve Shkolla jonë vë theks të veçantë në arritjet e nxënësve dhe kolektivi i arsimtarëve në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, nxënësve të dalluar u jep lëvdata dhe mirënjohje për arritjet e tyre. Këtë më së miri e shohim në pjesëmarrjen aktive të nxënësve tanë në garat komunale në dituri dhe në aktivitetet sportive që i organizon Komuna e Sarajit për çdo vit tradicionalisht “Olimpiadën e diturisë”. Në këto gara nxënësit tanë kanë korrur suksese duke zënë vendet më të larta si në dituri ashtu edhe në aktivitetet sportiv dhe këtë e dëshmojnë mirënjohjet dhe medaljet e fituara nga këto gara komunale. Vitet e fundit shkolla jone në garat e diturise ka treguar sukses te larte edhe ate te klasat e VI vendin e dytë nxënësi Krenar Matnjani te klasat e VII vendi i pare nxënësi Leart Idrizi dhe në garat sportive ka marë vende te mira. Arritjet personale te nxënësve, shkolla jonë i bën gjatë vitit shkollor duke filluar nga tremujori i parë, gjysmëvjetorin e parë, tremujorin e dytë dhe në fund të vitit shkollor. Nxënësve u japim fleta evidentuese ku shënohen notat e nxënësve, sjellja dhe rregullshmëria e tyre, pastaj ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga prindërit. Në fund të vitit shkollor tradicionalisht shkolla jonë verifikon të arriturat e nxënësve në çdo lëndë, analizohen të arriturat, në cilën lëndë ka rritje dhe në cilën ka rënie të suksesit, shpallet nxënësi më i mirë dhe klasa me sukses mesatar më të mirë në shkollë. - Promovimi i arritjeve në emër të shkollës. Shkolla jonë ka një politikë të nxitjes së kuadrit arsimor dhe të nxënësve që të marrin pjesë dhe të arrijnë sukses në garat komunale dhe rajonale, bën parapërgatitje në formë kuizi, vlerësohen nxënësit në formë gojore. Nxënësit më të dalluar dhe nxënësi që tregon më tepër sukses gjatë testimit e përfaqëson shkollën në garat e ndryshme komunale dhe rajonale. Shkolla jonë çdo herë e ka parasysh promovimin e arritjeve të shkollës sonë,

	organizohen teste diturish në nivel të shkollës, çdo rezultat raportohet në këshillin e shkollës dhe në këshillin e prindërve. Shkolla bën përpjekje të mëdha për një bashkëpunim më të madh mes prindërve dhe vetëqeverisjes lokale.
5.3 Barazia dhe të drejtat	
Burimi i të dhënave	Niveli i evaluimit: Shumë mirë
- Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik - Raport për përfshirjen e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimorë - Struktura e paraleleve - Biseda me nxënësit - Biseda me prindërit - Intervista gojore me shërbimin profesional - Ditari për punën e shërbimit profesional	- Njohja e të drejtave të fëmijëve Të gjithë të punësuarit në shkollën tone i dinë dhe i respektojnë të drejtat e fëmijëve, poashtu edhe nxënësit respektohen në mes vete pa dallim e gjinie dhe këtë më së miri e shohim edhe nga bisedat e bërë me nxënës, mësimdhënës dhe prindër.
	- Trajtimi i drejtë dhe i barabartë i të gjithë nxënësve Duhet theksuar se në shkollën tone nuk kemi patur raste të mostolerancës dhe respektit të ndërsjellë pa marrë parasysh gjininë si dhe vendin nga vijnë pasi që në shkollën tonë kemi edhe nxënës që vijnë nga shkollat periferike të fshatit Svillarë e Eperme të cilët vijnë në mësimin prej klasës së gjashtë deri në klasën e nëntë. Mësimi në shkollën tonë realizohet në dy ndërrime, në ndërrimin e parë mësojnë nxënësit e ciklit të lartë (VI-IX), kurse në ndërrimin e dytë mësojnë nxënësit e ciklit të ulët (I-V). Shkollën fillore “Bedri Tairi” –ne vitin shkollor 2023/24 e vijnë në mesimin gjithësejt 455 nxënës, nxënës nga shkolla qendrore dhe periferike. Këtu mund të cekim se deri më tani në shkollën tonë nuk ka pas asnjë zënkë mes nxënësve edhe pse mësimin e vijnë nxënës nga tre fshatra të ndryshëm, kjo do të thotë se shkolla jonë i kushton rëndësi të veçantë sjelljes, disiplinës dhe tolerancës mes nxënësve. Nxënësit tanë në shkollën tone mësojnë dhe respektojnë njëri tjetrin, këtë mund ta shohim edhe nga bisedat dhe intervistat e bëra me nxënës, prindër dhe mësimdhënës.
	- Pranimi dhe promovimi i multikulturës Shkolla jonë është institucion i hapur dhe tolerant ku promovohet multikulturalizmi dhe vepohet drejt evitimit dhe heqjes së stereotipeve.

5.4 Marrëdhënie partnere me prindërit dhe me bashkësinë lokale dhe afariste

Burimi i të dhënave

- Raporti për punën e shkollës (gjysmëvjetor, vjetor)
- Procesverbalet e këshillit të prindërve
- Procesverbalet e mbledhjeve prindore
- Intervistë me drejtorin
- Bisedë me shërbimin profesional
- Biseda me mësimdhënësit
- Biseda me prindërit dhe nxënësit
- Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike
- Statuti i shkollës
- Marrëveshjet me bashkësitë afariste
- Projektet e shkollës për aktivitetet jashtëmësimorë të nxënësve

Niveli i evaluimit: Shumë mirë

- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit

Shkolla jonë ka një bashkëpunim relativisht të mirë me prindërit, por në këtë drejtim duhet angazhim më i madh. Caktohen mbledhje të rregullta brenda vitit shkollor si dhe takime të ndryshëm në interes të nxënësve.

Sa i përket suksesit dhe rregullshmërisë së nxënësve, prindërit njohtohen me kohë nga mësimdhënësit me anë të fletave evidentuese dhe nga raporti i përgatitur nga shërbimi profesional ku në detaje raportohet para këshillit arsimor, këshillit të prindërve dhe këshillit të shkollës.

Deri tani në shkollën tone nuk është adresuar asnjë ankesë nga ana e prindërve. Shpesh ndodh që shkolla jonë të organizojë aktivitete jashtëmësimorë, ku edhe vet prindët participojnë me kontributin e tyre .

Këtë e shohim edhe gjatë këtij viti shkollor, kur shkolla jonë organizoi një aktivitet jashtëmësimor i titulluar “Klasa më e bukur”. Në këtë aktivitet u përfshinë gjithë nxënësit, punonjësit si dhe prindërit duke kontribuar që ky aktivitet të mbarojë me sukses. Për këtë aktivitet nga ana e një komisini të formuar nga ana e drejtorit u bë edhe përzgjedhja e klasës më të bukur, ku u ndanë edhe mirënjohje.

- Dokumentacion për donacionet

- ***Bashkëpunimi me bashkësinë lokale***

Shkolla jonë bashkëpunon me bashkësinë lokale të fshatit. Shpesh ndodh që për nevojat e ndryshme të shkollës të kontribojë edhe bashkësia lokale.

- **Bashkëpunimi me bashkësinë afariste dhe sektorin joqeveritar**

Kontribut të veçantë ka dhënë edhe hoxha i fshatit Kondovë i cili me rastin e fillimit të vitit shkollor të gjithë nxënësve që janë raste sociale të shkollës sonë u shpërndau çanta dhe mjete tjera mesimore.

Për festën e Bajrameve dhe Vitit të ri, një prind shpërndau paketa për nxënësit prej klasës së parë deri të pesten.

Shkolla jonë bashkëpunon me bashkësinë afariste.

Këtë mund ta tregojmë në disa raste, si blerja e derasave të bardha blerja e projektorëve për të gjitha klasat në të cilat mësojnë nxënësit.

Kjo është aritur me ndihmën e bashkësisë lokale të fshatit tonë, në bashkëpunim me afaristët dhe gjithë fshatarët që kanë kontribuar.

R e z u l t a t e t	
Përparësitë	Dobësitë
• Gatishmëria permanente për bashkëpunim të shkollës me prindërit • Bashkëpunimi me bashkësinë lokale • Bashkëpunimi me organizata joqeveritare • Bashkëpunimi me afaristë të fshatit • Marrëdhëniet e mira ndërmjet arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve	• Bashkëpunimi jo në nivel me prindërit. • Bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale duhet të përmirësohet. • Mungesa e salles sportive • Mungesa e fushes sportive ne Svillarë te Epërme

Analiza e rezultateve
• Shkolla jonë paraqet ambient i sigurt dhe i ngrohtë ku nxënësit mundën të përparojnë sipas mundësive dhe nevojave të veta me mbështetjen e plotë të të gjitha strukturave shkollore. • Në shkollën tone mësimi zhvillohet në një gjuhë edhe atë në gjuhën shqipe. • Kemi një shkollë periferike edhe në fshatin Svillare te Eperme. • Në shkollën tonë punohet në dy ndërrime.

- Marrëdhëniet në mes nxënësve dhe të punësuarve janë në nivel.

Aktivitetet në të ardhmen

- *Ti ruajmë raportet e mira ndërmjet të punësuarve dhe nxënësve në shkollën tone.*
- *Bashkëpunimi i shkollës sonë me prindërit të jetë në nivel më të lartë.*
- *Të vazhdojë bashkëpunimi me shoqatat qeveritare dhe joqeveritare.*
- *Bashkëpunimi me organizatat e sigurimit.*
- *Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me vetëqeverisjen lokale.*
- *Zgjerimi i hapësirës mësimore.*
- *Përmirësimi i kushteve mësimorë.*